



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në mbështetje të nenit 66 paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në paragrafin 1.3 dhe 1.5 të nenit 52, nenin 55 dhe 56 të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Drejtori i Sekretariatit të KQZ më datë 09.02.2024, nxjerr këtë:

### VENDIM

#### Për Anulimin e Konkursit të Shpallur për Pozitën Zyrtar i Lartë për Financa / Zotues me Numër Reference KQZ-16/2023

- I. Anullohet konkursi të shpallur për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa / Zotues, me numër reference KQZ-16/2023.
- II. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Sekretariati i KQZ më datën 24.02.2023 deri më 13.03.2023, ka publikuar konkursin me numër reference KQZ-16/2023, për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa / Zotues.

Gjatë procedurave të rekrutimit, komisioni përzgjedhës ka zhvilluar procedurën konform Rregullores Nr.03/2017, për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese në Sekretariatit e KQZ. Zbatimi i kësaj rregullore ka paraqitur dilemë nga fillimi shkaku i bazës së paqartë ligjore por edhe ndryshimit të bazës ligjore në vitin 2020, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtares Publik (LZP) por edhe me Aktgjykimin në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë vitit 2023 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZPRK) përfundimisht në mënyrë shprehimore në paragrafin 2 të nenit 66 i jep të drejtën KQZ që marrëdhënien e punës ta rregulloj në pajtim me ligjin zyrtarëve publik duke përcaktuar “Zyrtarët e Sekretariatit e kanë statusin e zyrtarit publik. KQZ, në pajtim me Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publik, miraton aktet nënligjore lidhur me marrëdhënien e punës së tyre, duke përfshirë sistematizimin dhe klasifikimin e pozitave në kuadër të KQZ dhe organeve të saj”.

Neni 127 i -LZPRK, e ka obliguar KQZ, që brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi të këtij ligji të bëjë harmonizimin dhe sistematizimin e stafit të administratës (sekretariatit të KQZ-së), në përputhje me LZP dhe ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë. Në ndërkohë Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publike shfuqizohet dhe hyn në fuqi Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

KQZ, me qëllim të zbatimit të nenit 66 dhe 127 të LZP, dhe në pajtim me Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ka miratuar Rregullat e brendshme të KQZ, në muajin janar të viti 2024 duke shfuqizuar edhe Rregulloren Nr.03/2017, për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese në Sekretariatit e KQZ në bazë të së cilës është bazuar edhe konkursi i datës 24.02.2023 deri më 13.03.2023 për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa / Zotues.

Paragrafi 1 i nenit 55 i Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) përcakton “Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë” ndërsa rastet e paligjshmërisë janë të përcaktuara në nenin 52 të LPPA e që gjatë anulimit të këtij konkursi është marrë parasysh paragrafi 1.3 dhe 1.5 i nenit 52 të LPPA.

Duke marrë parasysh që ky konkurs është hapur 1 vit më parë dhe ka kaluar çdo afat ligjor dhe nuk është përfunduar, përbën shkelje të rregullave ligjore procedurale në kuptim të nenit 1.3 të nenit 52 LPPA dhe duke marrë parasysh që deri sa procedura është në vazhdim është bërë ndryshimi i bazës ligjore përfshirë LZPRK dhe LZP dhe legjislacioni sekondar që rregullon pranimin në KQZ, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 09.02.2024

  
Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së

Ky vendim i dorëzohet:

Divizionit për Burimeve Njerëzore,

Arkivit